



PPP.nr. 274/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Naime Ahmeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve Fatjon Thaqi dhe Besmir Thaqi, që të dy nga Malisheva, Rr.Hamdi Berisha, nr. 13, , kundër debitorit Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore për borxh në vlerë 2,400.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.710/14 datë 10.10.2014, të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Afet Mjeku nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 11.01.2017, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si bazuar prapësimi i debitorit: Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë dhe ANULOHT Urdhri Përmbartimor P.nr. 710/14 datë 10.10.2014, i përmbartuesit Afet Mjeku.

A r s y e t i m

Përmbartuesi privat në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktvendimit të datës 15.01.2014, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin konsideron se urdhri për ekzekutim është i parregullt, dhe kërkon nga gjykata ta vërtetoj gjendjen faktike, sepse borxhi është paguar nga skema PPAK-ut pensionet për fëmijë me aftësi të kufizuara për 10 muaj, nga 100 € në totalin e shumë prej 1.000,00 €, që do të thotë se kreditori shumë e lartcekur e ka realizuar gjatë vitit 2013, me tej ka theksuar se i njëjti kreditor pas vlerësimit të komisionit mjekësor ka kaluar në skemën e personave të verbër sipas ligjit Nr.04/L-92 , ku sipas këtij ligji kompensimi financiar për efekte e verbërisë është 100, që do të thotë se nuk mundet i njëjti të paguhet dy herë për të njëjtën çështje. Andaj debitori ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet prapësimi dhe urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditorët nuk kanë paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit.

Kjo gjykatë duke vepruar edhe sipas udhëzimeve të aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.3340/15 i datës 14.03.2016, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për këto arsye:

Gjykata vlerëson se debitori me aktvendimin e datës 15.01.2014, kreditorëve ua ka njohur kompensimin për të verbër kreditorit Fatjon Thaqi në shumë mujore nga 100.00 euro dhe kreditorit Besmir Thaqi i është pranuar kompensimi si shoqëruese e personit të verbër, në shumë prej 100.00 euro, në muaj.

Gjykata vlerëson se aktvendimi nuk është pajisur me vërtetim të plotfuqishmërisë dhe me vërtetim të përbarueshmërisë, ndërsa përbaruesi privat para lejit të përbarimit nuk ju ka kërkuar kreditorëve që aktvendimi të pajiset me këto vërtetime dhe nuk ka vërtetuar faktin se cila pjesë e kompensimit është paguar e cila pjesë e kompensimit ka mbetur me u paguar me ekspertë financiar.

Në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e Urdhrit Përbarimor nga ana e përbaruesit, sepse aktvendimi i marrë në procedure administrative nuk ka vërtetim për përbarueshmëri, në kuptim të nenit 36 par.1 të LPP-së, si kundër nuk është vërtetuar se debitori a ka paguar ndonjë shumë të kreditorëve, nëse ka paguar atëherë duhet të vërtetohet se cila pjesë ka mbetur pa paguar. Kështu kjo gjykatë vendosi të anuloi urdhrin përbarimor duke pranuar prapësimin e debitorit.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të aktvendimit e duke bazuar nenin 73 par.3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PPP.nr.274/16, dt.11.01.2017



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.